REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LUSHNJE

Nr 10137 Prot. Lushnje , më 12.11.2025

R E L A C I O N

KESHILLIT BASHKIAK

"MBI PËRDORIMIN E FONDIT REZERVË PER MBULIMIN E SHPENZIMEVE PËR KLUBIN E FUTBOLLIT LUSHNJE"

Të nderuar zoterinj këshilltarë!

Në mbështetje të Ligjin nr. 139 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, neni 54 germa dh, Ligjit nr.9936 datë 26.06.2008, "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, neni 6, në Udhëzimin nr.9 datë 20.03.2018 të Ministrisë së Financave "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit" pika 132-135, Ligji nr 68/2017 i ndryshuar "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", bazuar në shkresën nr 329 datë 10.11.2025 nëpërmjet të cilës kërkohet fond shtesë për Klubin e Futbollit Lushnje, u diskutua të përdoret Fondi Rezervë për të mbuluar shpenzimet e Klubit të Futbollit Lushnje në vlerën 5,500,000 lekë pasi gjatë ushtrimit të aktivitetit janë shfaqur shpenzimë të paparashikuara në vitit 2025 për të cilat është përdorur plani i muajit Dhjetor duke bërë një avancim plani në mujin Gusht 2025.

Kërkojmë të pakësohet Fondi Rezervë (Programi AF,Produkti V491AAA) në vlerën prej 5,500,000 lekë dhe të shtohen shpenzimet operative (Programi AE129, Produkti V813AAC-00-05-603 Mbështetje për Klubin e Futbollit) për 5,500,000 lekë.

Ju faleminderit!

KRYETAR I BASHKISË

Eriselda Sefa

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LUSHNJE

Adresa: Lagja "Kongresi" Tel/Fax: +355 35 22139 E-mail: bashkia_lushnje@yahoo.com

10098
11.11.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
"K.F. LUSHNJA 1930" sh.a.

Nr 329 Prot. Datë 10/11/2025

Drejtuar: Presidentit te Klubit te Futbollit Lushnja 1930 sh.a Znj.Eriselda Sefa,

Asamblesë Së Përgjithshme Të Klubit Të Futbollit Lushnja 1930"Sh.a

Lënda: Kërkesë për rritje fondi për mbulimin e pagave dhe parapagim per nënshkrimin e kontratave për lojtarët e " Klubi i Futbollit Lushnja 1930" Sh.a .

E nderuar Presidente , të nderuar anëtre të Asamblese së përgjithëshme

Në kuadër të vazhdimësisë, për sezonin futbollistik, si dhe për të siguruar stabilitetin financiar të klubit, ju paraqesim këtë kërkesë për rritjen e fondit të disponueshëm me shumën prej 5.500.000 (pesë million e pese qinde mije) lekë.

Kjo shumë do të shërbejë për:

- Mbulimin e pagave mujore të stafit teknik dhe futbollistëve, duke garantuar vijueshmërinë dhe stabilitet financiar.

Duke marrë parasysh rëndësinë e kësaj periudhe për klubin, konsiderojmë se mbështetja juaj financiare është thelbësore për të arritur objektivat sportive dhe organizative të vendosura.

Në pritje të miratimit tuaj, ju falënderojmë për mbështetjen e vazhdueshme dhe angazhimin ndaj klubit.

Me respekt,

Administratori

KF.Lushnja 1930

Z.Marjus Lička

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KESHILLI BASHKIAK LUSHNJE

Nr 10137/1 Prot. Lushnje , më 12.11.2025

PROJEKT-VENDIM

NR. 103 DATË 12/11/ 2025

"MBI PËRDORIMIN E FONDIT REZERVË PER MBULIMIN E SHPENZIMEVE PËR KLUBIN E FUTBOLLIT LUSHNJE"

Këshilli Bashkiak Lushnje në mbledhjen e tij të datës ____/____/ 2025, bazuar në relacion e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë "Mbi përdorimin e fondit rezervë", si dhe në mbështetje të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 *"Per veteqeverisjen vendore"* , neni 54 germa dh, Ligjit nr.9936 datë 26.06.2008, "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, neni 6, në Udhëzimin nr.9 datë 20.03.2018 të Ministrisë së Financave "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit" pika 132-135, Ligji nr 68/2017 i ndryshuar "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", ju:

PROPOZOJMË:

1.Të miratojë ndryshimin në Buxhetin e vitit 2025 për përdorimin e Fondit Rezerve në masën *5,500,000 (pesë milion e pesëqind mijë*) lekë për Klubin e Futbollit Lushnje.
2. Në aparatin e Bashkisë të pakësohet fondi rezervë (Programi AF,Produkti V491AAA-00-01-604 Fondi Rezerve) në vlerën prej *5,500,000 lekë* dhe të shtohen shpenzimet operative (Programi AE129, Produkti V813AAC-00-05-603 Mbështetje për Klubin e Futbollit) për *5,500,000 lekë.*,
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Finances dhe Buxhetit dhe Qendra e Kulturës dhe Klubi Shumë Sporteve.
4. Ky vendim hyn ne fuqi 10 dite pas shpalljes.

Drejtoria Fianacë - Buxhetit
Ervisa Çuko

Drejtoria Juridike
Bedri Hida

KRYETAR I BASHKISË
Eriselda Seta

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA LUSHNJE

Adresa: Lagja "Kongresi" Tel/Fax: +355 35 22139 E-mail: bashkia_lushnje@yahoo.com